



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2017

V E N D I M

Nr.153, datë 29.12.2017

Mbështetur në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 97, datë 03.10.2016 e Znj. D.P., kundër shkollës së mesme profesionale “Sali Ceka” Elbasan, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “etnisë”¹ dhe “gjendjes ekonomike”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, ankuesja D.P. është nënë e tre fëmijëve, të cilët jetojnë me të dhe ka të ardhura të kufizuara prej prej 3000 lekësh në muaj nga ndihma ekonomike². Njëri nga fëmijët, A.K. është nxënëse në shkollën e mesme profesionale “Sali Ceka” në Elbasan, por për shkak të gjendjes ekonomike në të cilën ndodhet e ka të pamundur që t’ia blejë vet librat. Znj. D.P. pretendon se në bazë të VKM nr. 911, datë 11.11.2015³, fëmijët e komunitetit egjiptian i përfitojnë tekstet shkollore falas, por ky vendim nuk po zbatohet nga drejtorja e shkollës së mesme profesionale “Sali Ceka”.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 32, pika 2 e ligjit 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”*, përmes shkresës nr. 910/1 prot, datë 12.10.2016, Komisioneri

¹ Znj. D.P. i përket komunitetit egjiptian të qytetit të Elbasanit.

² Ankuesja ka statusin civil “divorcuar”

³ Vendimit nr. 911, datë 11.11.2015³ “Për parçaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e pagesave dhe për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, për nxënësit e studentët në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2015-2016”

iu drejtua shkollës së profesionale “Sali Ceka” në Elbasan, ku iu kërkua informacion mbi zbatimin e VKM nr. 911, datë 11.11.2015 dhe situatën e shpërndarjes së librave për fëmijët e komunitetit egjiptian të kësaj shkolle. Në kthim përgjigjen e drejtorisë së shkollës së mesme profesionale “Salih Ceka”⁴, Komisioneri informohet se A. K., nxënëse në klasën e 10-të, dega “Hoteleri-Turizëm”, është pajisur me tekste shkollore falas. Shkresës së drejtorisë së shkollës i është bashkëlidhur një dokument me emrat e nxënësve, të cilët kanë firmosur mbas marrjes së librave nga shkolla. Ndër to figuron edhe firma e nxënëses A. K.

Përmes shkresës së datës 11.10.2016 të “Lëvizjes Rinore Egjiptiane-Rome”, Komisioneri është bërë gjithashtu me dije se më datën 04.10.2016 drejtorja e shkollës “Sali Ceka” ka pajisur me tekste shkollore falas fëmijët e komunitetit egjiptian, ndër to edhe fëmijën e znj. D.P.

Përsa më sipër, gjykojmë dhe vlerësojmë se kërkesa e e znj. D.P. është plotësuar dhe vajza e saj, Alketa Kurti, nxënëse në klasën e 10-të të shkollës së mesme profesionale “Sali Ceka”, tashmë ka marrë tekste shkollore falas, sipas dispozitave ligjore të përcaktuar në Vendimin nr. 911, datë 11.11.2015 të Këshillit të Ministrave.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 1, 3, 7, 11, 12, 17, 18, 19, 21, pika 1, 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe Vendimit nr. 911, datë 11.11.2015 të Këshillit të Ministrave, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 97, datë 03.10.2016 të znj. D.P., pasi është arritur qëllimi.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

KOMISIONERI

IRMA BARAKU

Shkak – etnia, gjendja ekonomike

Fusha – arsim

Lloji I vendimit – pushim shqyrtimi/arritje qëllimi

⁴ Shkresë nr. 42 prot, datë 17.10.2016

